

JO VETËM UNË, TË GJITHË


AUTOKRACIA

Sundon
vetëm një
person




OLIGARKIA

Sundojnë
disa persona



DEMOKRACIA


Sundojnë
të gjithë



DEMOKRACIA, SISTEM I VLERAVE

BENJESA (14), ANESA (14), FJOLLA (14), DJELLART (15), BLEON (14), GENT (15), ALDRIN (13),

BLEONIT (14)



Lexues të nderuar, në këtë artikull do të keni mundësi të mësoni për tri sistemet e qeverisjes që ne i njohim

Ne jemi nxënës të klasës së IX-të. Përgjatë viteve të shkollimit, ne nga lënda e historisë kemi mësuar se janë të njohura disa sisteme të qeverisjes. Ne, vazhdimisht jemi munduar që të bëjmë krahasime mes

lumtur që shteti ynë është demokratik. Kjo vë nga fakti se shteti ynë karakterizohet me shprehje të lirë të mendimit, barazi, respekt, tolerancë dhe solidaritet. Por, ajo që e fuqizon më së shumti shtetin tonë demokratik është se populli vendos për qeverisjen e vendit e që sistemet e tjera nuk e gëzojnë këtë liri që populli ynë e ka.

Ne e dimë se në autokraci udhëheq vetëm një person, në oligarki vendos vetëm një grup njerëzish që janë elitë, kurse në demokraci vendos i tërë populli. Andaj, me bindje të plotë themi se në demokraci gëzojmë shumë të drejta që sistemet e tjera qeverisëse nuk i kanë. Demokracia, aq shumë i jep vlerë qytetarëve sa edhe tërë pushtetin ua lë në dorë atyre, sepse ka besim të madh në përzgjedhjen që ata e bëjnë. Prandaj, ju ftojmë të gjithëve që ta ruajmë, ta mbajmë dhe ta zhvillojmë demokracinë që e kemi. Kështu ndërtohet shteti ynë demokratik.



Fuqia i takon popullit

këtyre sistemeve dhe ta shohim se cili sistem është më i miri. Secili nga sistemet, ka tiparet e veta dalluese. Duke e bazuar në këto tipare kemi vërejtur se kishte dallime të mëdha mes tyre. Sistemet për të cilat po flasim dhe që ne i njohim janë: sistemi autokratik, sistemi oligarkik dhe sistemi demokratik. Për të bërë përzgjedhjen e sistemit që është më i miri, u bazuam në sistemin që i jepte fuqi popullit. Ky sistem ishte sistemi që ne sot e gëzojmë, prandaj jemi shumë të



Grupi më i mirë i demokratëve të rinjë

NE ZGJODHËM TË JEMI QYTETARË AKTIV

ERION (13), OLT (14), DIJON (14), ELSA (14), RINESA (14), ANITA (14), TUANA (14), VENIS (15)




PROGRAMI I NJË KANDIDATI PËR DEPUTET NË KUVENDIN E KOSOVËS

- DO TA NDËRTOJNË NJË SHKOLLË 9 VJEÇARE NË LAGJEN MATIÇAN.
- DO TA BËJMË TATIMIN PROGRESIN MBI TË ARDHURAT E POPULLIT.
- DO TA BËJMË PASTRIMIN DHE NDRIÇIMIN PUBLIK NË KOSOVË.
- DO TË HAPIM INSTITUCIONE PUNE DHE TË PUNËSOJMË TË RINJTË E KOSOVËS.
- DO TA ZVOGËLOJMË VARFËRINË NË KOSOVË.
- DO TË HAPIM JETIMORE.
- DO TË HAPIM NJË SHTËPI PËR TË PASTREHËT.

Një kandidat për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës duke treguar programin e vet para qytetarëve të Kosovës

Ne jemi në anën e atyre të cilët do të punojnë për të mirën e Republikës së Kosovës

Demokracia është formë e qeverisjes apo sundimit të një shteti. Ajo mbështetet në vendimet e popullit. Me anë të votës së lirë, populli i zgjedh kandidatët të cilët mendon se janë të denjë ta përfaqësojnë vendin. Vendi e përfaqësojnë deputetët, të cilët japin premtime



të shumta dhe që i realizojnë premtime e dhëna. Ne mund të votojmë që nga moshë 18 vjeçare, sepse ne në atë moshë jemi më të pjekur, mund të vendosim vetë dhe nuk ndikohemi nga askush. Çdo deputet që zgjedhet e ka mandatin për 4 vjet. Pas 4 vjetëve bëhen zgjedhjet e reja dhe mund të zgjedhet i njëjti kandidat apo dikush tjetër. Nëse ai/a jo gjatë mandatit 4 vjeçar i ka mbajtur të gjitha premtimet e dhëna, ka punuar shumë dhe populli është i kënaqur me punën e tij/saj, ka mundësi të zgjedhet përsëri edhe për një man-

dat tjetër. Kandidatët për deputetë japin premtime të ndryshme që shteti të arrijë sa më shumë. Kurse, neve si qytetarë të Republikës së Kosovës, një gjë që mund të na bëjë qytetarë aktiv pasi t'i kemi mbushur 18 vjet është të dalim të votojmë çdo herë që ka zgjedhje. Në këtë mënyrë, ne kontribuojmë për të mirën e vendit. Një gjë tjetër që mund të na bëjë neve qytetarë aktiv është edhe pagimi i tatimeve. Në këtë mënyrë, shteti i merr ato para dhe pastaj bën investime të ndryshme në vend, si: ndërtimin e shkollave të reja, spitaleve, çerdheve, etj. Qytetarë aktiv mund të jemi edhe nëse lajmërojmë parregullsitë në organet kompetente, si për shembull nëse e shohim dikë duke manipuluar votuesit e rinjë. Ne si qytetarë do të votojmë çdo herë, përderisa përfaqësuesit tanë do të punojnë shumë për t'i mbajtur premtimet e tyre.




Autorët e artikullit

PA PUSHTET NUK MUND TË KETË NDARJE TË PUSHTETIT

DAFINA (15), RINA (14), VINETA (14), EDA (14), FIONA (14), VALTON (14), BLENDRIT (14),

ARXHIRA (14), DRILON (15)



Koncepti i ndarjes së pushtetit përbëhet prej dy komponenteve të tilla si: „pushteti“ dhe „ndarja“


Demokracia si sistem e ka pothuajse të pamundur të funksionojë nëse nuk ka qytetarë të mirë, punëtorë dhe të cilët punojnë për të mirën e saj. Por, pa e harruar po ashtu edhe praninë e institucioneve, që nuk ka dyshim që kanë rëndësi shumë të madhe për funksionim të drejtë të shtetit. Që shteti të udhëhiqet në mënyrë demokratike, që të gjithë të kenë të drejta të barabarta, që respekti dhe mirëkuptimi të jenë përditëshmëri e çdo qytetari, janë falë punës së palodhshme që institucionet tona bëjnë.

Ndoshta e vërejtët edhe ju, të dashur lexues, fakti që cekëm për punën që këto institucione e bëjnë, na lë të kuptojmë që të gjitha punojnë në mënyrë të pavarur. Por, pse punojnë ato në mënyrë të pavarur? Sepse të gjitha kanë për qëllim mirëqenien e qytetarëve, duke investuar kështu në zhvillim ekonomik, shëndetësi dhe kushte më të mira, shkollim më cilësor, etj. Atëherë, të gjithë këto institucione, për të pasur rezultat pozitiv dhe ndikim më të madh në jetën e qytetarëve, funksionojnë në mënyrë të ndarë nga njëra-tjetra. Të tillë funksionuam edhe ne sot, të gjithë të përkushtuar në përgjegjësinë e vet. Edhe pse, ne merrim mendime nga shokët dhe shoqet e tjera, në fund prapë vendoste secili për vete se çka duhet të bëjë më tutje. E mund të themi së në mënyrë të njëjtë funksionojnë edhe institucionet shtetërore. Këtë gjë e ka paraparë Kushtetuta e Kosovës, e cila në nenin 4 të saj tregon sesi pushteti në vendin tonë është i ndarë dhe se cili institucion

ushtron çka. Kushtetuta, Kuvendin e Kosovës e njëh si Pushtetin Legjislativ, Qeverinë e njëh si Pushtetin Ekzekutiv dhe Gjykatën e njëh si Pushtetin Gjyqësor. Edhe ne qytetarët, i njohim si të tilla këto institucione. Ne do të ndalemi tek Pushteti Gjyqësor, sepse për dy pushtetet e tjera do t'iu tregojnë pjesa e tjetër e grupit. Pushteti Gjyqësor ka për qëllim të vendos drejtësi në vend. Këtë e bën duke i ndëshkuar të gjithë ata, të cilët veprojnë në kundërshtim me ligjin. Vineta, shoqja jonë, e kishte detyrën e këtij pushteti dhe ajo veprroi drejt kur shoqja Dafinë dhe shoku Valton rezistuan t'iu përmbahen rregullave të grupit. Rregulla këto që ne së bashku i vendosëm. Ajo në paanshmëri vendosi që Dafina dhe Valtoni së pari duhet të kërkonin falje nga grupi dhe nëse grupi pranon, ata t'iu bashkangjiten punës grupore prapë. Ndoshta duket pak e vrazhdë, por në realitet çdo njeri është përgjegjës për veprimet e veta. Ky ishte vetëm një shembull, që ne të gjithë bashkëpunuam dhe nuk pati ndëshkime. Qytetarët e ndërgjegjshëm nuk i thyejnë rregullat.



Qytetarë punëtorë, bashkëpunues dhe shumë të motivuar



Këtu kemi paraqitur dy institucione, roli i të cilave është shumë i madh në jetën tonë. Në anën e majtë, kemi paraqitur një qytetar dhe Kuvendin, për të bërë me dije që ky institucion zgjedhet direkt nga populli. Kurse, në anën tjetër, kemi paraqitur Qeverinë, e cila po ashtu punon për të mirën e popullit dhe zgjedhet nga deputetët.

Në artikullin paraprak, shoqet dhe shokët kanë treguar më shumë se si ndahet pushteti në vende demokratike. Ndërsa, ne do t'iu informojmë më shumë se cili institucion, cilin pushtet e ushtron. Fillojmë me Kuvendin e Republikës së Kosovës, i cili e ushtron funksionin legjislativ. Qohet funksion legjislativ, sepse ky institucion miraton ligjet, të cilat propozohen nga vetë deputetët, nga Qeveria, nga Presidenti apo edhe nga një numër i konsiderueshëm i qytetarëve, më saktësisht 10.000. Këto ligje që miratohen në Kuvend, kanë rol dhe rëndësi shumë të madhe në jetën e secilit qytetar, si atyre që kanë nevojë të veçanta, po ashtu edhe atyre që nuk kanë nevojë të veçanta.

Ligjet që fillimisht janë projektligje, votohen nga deputetët, të cilët gjithsej janë 120. Këta deputetë, janë shembull për të gjithë ne qytetarët. Institucioni tjetër

që e ushtron pushtetin tjetër është Qeveria.

Qeveria, ndryshe njihet si pushteti ekzekutiv, qëllimi i së cilës është t'i zbatoj të gjitha ligjet që i ka miratuar Kuvendi. Qeveria është institucion që mendon shumë për mirëqenien e të gjithë qytetarëve. Këtë e bën me propozimin e projektligjeve që ia dërgon Kuvendit. Janë ministritë e ndryshme ato që propozojnë projektligje të ndryshme.

Për shembull, Ministria e Shëndetësisë propozon projektligje për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me shëndetësinë. Ose, Ministria e Infrastrukturës propozon projektligje për infrastrukturë. Në këtë mënyrë, funksionojnë të gjitha ministritë, sepse që të gjitha kanë për qëllim mirëqenien e qytetarëve. Gjithsej janë 21 ministri, që janë në dispozicion të 1.8 milionë banorëve.



Me ndarjen e detyrave në grup, u munduam që secili nga ne të ketë përgjegjësi të ndryshme për përfundimin e artikullit. Të gjithë punuam në mënyrë të pavarur, por gjithmonë duke u konsultuar në mes vete. Pothuajse njëjtë siç funksionojnë edhe institucionet që ushtrjnë pushtete të ndryshme



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Mitrush Kuteli“
Klasa: IX-2
Vendi: Prishtinë